



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Prill 2021

Nr. 326

**VENDIM**

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Bashkisë Tiranë
- Kërkues:** Partia Demokratike e Shqipërisë
- Ndaj:** Bashkisë Tiranë
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREN:**

I. Vlerësimi paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 29.03.2021, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë,



denoncimi me nr. 2579 ID unik i gjeneruar nga sistemi, për një aktivitet publik të transmetuar në të gjithë mediat e vendit, me praninë e Kryeministrit z. Edi Rama, Ministrit të Shtetit për Rindërtim z. Arben Ahmetaj, Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë zj. Belinda Balluku dhe Kryebashkiakut z. Erion Veliaj i cili nënshkroi, kontratat e porosive për përfituesit e banesave në lagjen e re KombinArt si pasojë e tërmetit të 26 nëntorit 2019.

Bashkangjitur denoncimit të kërkuesit janë paraqitur aktet provuese:

Link: <https://www.balkanweb.com/nis-nenshkrimi-i-kontratave-per-familjet-qe-do-te-strehohen-ne-lagjen-e-re-kombinart-veliaj-marrin-prone-me-vlere-te-shtuar/>

Link: <https://www.youtube.com/watch?v=OEVIhHn5pcc&t=68s>

Sipas përcaktimeve të nenit 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 82 e vijues, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga kallëzuesi Partia Demokratike e Shqipërisë, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II. Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ, më datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9/2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.



Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në kallëzimin e datës 29.03.2021, nr.2579 ID, pretendohet se nënshkrimi i kontartave të porosisë, në një aktivitet publik, bie në kundërshtim me nenin 1, pika 1.1, shkronja “d” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ku parashikohet se:

“**veprimtari të ndaluara për t’u promovuar** janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

d) mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3291 prot., datë 06.04.2021, i ka kërkuar z. Alban Dokushi, Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licensimit, Bashkia Tiranë, informacion sqarues, lidhur me këtë aktivitet.

Me shkresën nr. 14357/1 datë 16.04.2021 protokolluar pranë KQZ me shkresën nr. 3291/1 datë 16.04.2021, Bashkia Tiranë ka kthyer përgjigje ku parashtron dhe argumentat përkatëse. Në përgjigjen e dhënë, bëhet e ditur se aktiviteti objekt kërkesë, është zhvilluar në sajë të procesit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 dhe fondi i miratuar apo procedurat përkatëse për këto janë përcaktuar para vendimit nr. 9/2020, përkatësisht me Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave, miratuar me ligjin nr. 97/2019. Sa më sipër, aktiviteti i kryer nuk ka shkelje të këtij vendimi dhe dispozitave ligjore dhe nuk mund të konsiderohet publik pasi në të kanë marrë pjesë vetëm disa pjesëtarë të familjeve përfituese dhe një numër të kufizuar të titullarëve të organeve përgjegjëse të ngarkuara për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe në asnjë rast nuk ka qënë I hapur për pjesëmarrjen e publikut apo medias.

### III. Analiza juridike dhe konkluzione

Referuar nenit 2, shkronja “b”, të vendimi nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, “**Veprimtari publike**”, janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katërmujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut



rreth tyre. Referuar denoncimit të mësipërm, vlerësoj se aktiviteti i kryer në datën 28.03.2021, me pjesëmarrjen e Kryeministrit z. Edvin Rama, Ministrit të Shtetit për Rindërtim z. Arben Ahmetaj, Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë znj. Belinda Balluku dhe Kryebashkiakut z. Erion Veliaj **konsiderohet veprimtari publike** në kuptim të nenit 2, shkronja “b” e vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 3, pika 1, nëndarja 1.1 përcakton se veprimtari të ndaluara për t’u promovuar janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë **vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve** dhe që përfshijnë:

d) mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.

Këshilli i Ministrave, me Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me ligjin nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”” ka si objekt rregullimin e funksionimit të organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Bashkia Tiranë, si njësi vetëqeverisëse vendore, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për përballimin e fatkeqësive natyrore, e ka nisur punën për krijimin e kushteve për strehim të përhershëm për përfituesit e programit të rindërtimit nga momenti i hyrjes në fuqi të aktit normativ të mësipërm. Neni 3, pika 1, nëndarja 1.1 e kufizon fushën e veprimit në ato veprimtari publike për të cilat janë **vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.**

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprimtari të vëna rishtazi dhe as me fonde publike të transferuara jo sipas planit buxhetor të miratuar, pasi leja infrastrukturore është lidhur rreth 8 muaj më parë. Vlerësoj të rëndësishme të theksohet se nënshkrimi i kontratave të porosisë është në përmbushje të zbatimit në vazhdimësi të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

Në mënyrë që të kemi shkelje të shkronjës “d” ... *“mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore”*, duhet që fondet e përdorura për mbështetjen promovimin e këtyre objekteve të ishin vendosur **rishtazi apo posaçërisht në dispozicion** dhe të ishin



transferuar **jo sipas planit buxhetor të miratuar**, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Këto janë kushte kumulative të përcaktuara nga neni 3 dhe nuk mund të lexohen të ndara nga njëra-tjetra.

Sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezultoi e provuar se Bashkia Tiranë është në shkelje të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga Partia Demokratike e Shqipërisë, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e Bashkisë Tiranë nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 dhe vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Bashkisë Tiranë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 5 vjet  
Pano: \_\_\_\_\_  
I.Osmanaj \_\_\_\_\_  
M.Koja \_\_\_\_\_  
A.Lamçe \_\_\_\_\_  
Y.Merkaj \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_, 2021



Data: 28 Prill 2021  
Nr. 326

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Bashkisë Tiranë.